

sentë shkallës

1194/14
07 11 2017
Mjeste



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

PROKURORIA

PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA

Nr. 176/7 Prot.(D.P)
Urgjent / Konfidenciale

Tiranë më, 07 .11.2017

Lënda: Kërkesë për ndihmë juridike drejtuar Autoriteteve Gjyqësore të Italisë lidhur me procedimin penal nr. 134 të vitit 2016.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

*Drejtorisë së Përgjithshme të Jetësimit të Prioriteteve,
Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Integritimit
Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë*

TIRANË

Për dijeni:

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë

TIRANË

Mbështetur në nenin 15 të Konventës së Këshillit të Evropës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale, nenin 509 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 6 të Ligjit nr.10193, datë 03.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale", ju përcjellim bashkëlidhur, me qëllim transmetimin Autoriteteve Italiane të Drejtësisë, kërkesën për ndihmë juridike në kuadër të **procedimit penal nr. 134, të vitit 2016**, regjistruar për veprat penale të "Kultivimit të bimëve narkotike", "Trafikimi i narkotikëve" në bashkëpunim, Grupi i strukturuar kriminal", "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuara nga nenet 284, 283/a/2, 333/a dhe 260 të Kodit Penal.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTUESI I PROKURORISË

BESIM HAJDARMATAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3267/19 Prot./A.H
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

“Sekret”
Afati i ruajtjes së klasifikimit :30 vjet
Kopje Nr. 5
Tiranë, më 20/11/2017

URGJENT!

Lënda: Kërkesë për ndihmë juridike.

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS
PRANË GJYKATËS NË CATANIA
Piazza Verga - 95100 CATANIA (CT)
ITALI**

**Për dijeni: MINISTERISË SË DREJTËSISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË
Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë
Drejtorisë së Çështjeve Penale Zyrës II
Via- Arenula 70-00186
Romë, ITALI**

**Për dijeni: PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS
SË PARË PËR KRIME TË RËNDA TIRANË**

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të Konventës Europiane “Mbi Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale” të vitit 1959, dhe protokollet shtesë të saj, të “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si Shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin, të 13 Dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, të 20 Prillit 1959, që ka si Qëllim të Lehtësojë Zbatimin e Tyre”, të nenit 509 të Kodit Shqiptar të Procedurës Penale, të neneve 6 dhe 13 të Ligjit Nr.10193, datë 3.12.2009, “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, transmeton letërporosinë Nr. 176 Prot./D.P, datë 07.11.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në lidhje me procedimin penal Nr. 134, datë 08.07.2016, për veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Trafikimi i narkotikëve” dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga nenet 284/1, 28/4, 333/a, 334 283/a/2 dhe 260 të Kodit Penal Shqiptar.

Objekti i letërporosisë është kryerja e veprimeve procedurale dhe vënia në dispozicion e akteve të cituara në të.


SEKRET

Bashkëlidhur dokumentacioni.

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, përfiton nga rasti për t'i shprehur Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë, sigurinë për konsideratën e saj më të lartë.

MINISTRI

Etilda Gjona
ETILDA GJONAJ (SALIU)



SEKRET